



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:000658
Datë: 02.10.2024
Numri i dokumentit: 06243531

C.nr.55/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike-civile të paditësit I. K. nr. personal, nga Podujeva, të cilin e përfaqëson i autorizuari avokatura “K. & A.” me avokatët e saj S. K. etj., nga Prishtina, Ulpiana C-2, 2/6, me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., baza e kontestit: për shkak të kompensimit të Inflacionit, vlera e kontestit: 1,007.23 euro, jashtë seancës më datë 02.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË si e pa lejueshme, padia e paditësit I. K. nr. personal, nga Podujeva, kundër të paditurës Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., për shkak se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (Litispendenca).

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmes të autorizuarit të tij, ka paraqitë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, kundër të paditurës, padi për shkak të kompensimit të Inflacionit, në vlerën e kontestit si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta, gjeti se në këtë gjykatë nga paditësi është iniciuar padi në mes palëve të njëjta për kërkesën e njëjtë, e cila lëndë evidentohet me numër të regjistrimit C.nr.521/2022 (2022:099477) e datës së pranimit në gjykatë me datë 18.05.2022, (e cila lëndë mbetet aktive për shqyrtim), po ashtu edhe objekti i kërkesëpadisë është e njëjta, gjithashtu të dy këto lëndë kanë të bëjnë ndërmjet palëve të njëjta dhe me të njëjtën çështje (bazë).

Me nenin 262.3 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), është paraparë se: *“Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”*, ndërsa me nenin 262.4 është paraparë se: *“Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.”*

Po ashtu me nenin 391 par.1 pika c) të të njëjtit ligj, është përcaktuar se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca);”*.

Andaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitave të nenit 262.3 dhe 4, 391 par.1 pika c), të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u more në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i përgjithshëm
C.nr.55/2023 të datës 02.10.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.